



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

V E N D I M

Nr. 09, datë 05.04.2024

PËR

**MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN: "PETRO NINI BRICKS"
ME 3, 5, 7 DHE 9 KATE MBI TOKË DHE 3 KATE NËNTOKË, ME VENDNDODHJE
NË RRUGËN "SAMI FRASHËRI", BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë "Domus Group" sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Petro Nini Bricks" me 3, 5, 7 dhe 9 kate mbi tokë dhe 3 kate nëntokë, me vendndodhje në Rrugën "Sami Frashëri", Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqërinë "Domus Group" sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave si dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI


EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 24/01 / 2025